

2024

# HOUR OF CODE

09-13 DHJETOR



Me një paraqitje mbresëlënëse të entuziazmit për teknologjinë digjitale, Kosova iu bashkua për herë të dytë nismës globale "Hour of Code", duke shfaqur potencialin transformues të kodimit.

Përmes aktiviteteve interaktive, sesioneve praktike dhe qasjeve gjithëpërfshirëse në mësim, kjo ngjarje jo vetëm që nënvizoi rëndësinë e shkathtësive digjitale, por gjithashtu vendosi standarde të reja për të ardhmen e arsimit në vendin tonë.


**85,000** orë kodimi

**350** shkolla

**24** komuna




Aktiviteti më i përdorur gjatë Orës së Kodimit ishte **Minecraft**, i cili u vlerësua për mënyrën argëtuese dhe interaktive të mësimin të kodimit.



## EVALUIMI I JAVËS NGA NXËNËSIT

Procesi i vlerësimit nga nxënësit gjatë Javës së Kodimit u hartua për të vlerësuar progresin dhe aftësinë e pjesëmarrësve në aftësi të ndryshme kodimi.

- Sa ju pëlqyen aktivitetet e Orës së Kodimit?



- A keni dëshirë të mësoni kodimin në shkollë?



## AKTIVITETET DHE TRAJNIMET

Java e Orës së Kodimit paraqiti një gamë gjithëpërfshirëse të aktiviteteve të organizuara në tri trajnime të ndara për mësimdhënësit e shkollave sipas niveleve para-fillorë, klasat 1-5 si dhe për mësimdhënësit e nivelit 6-12.



Janë mbajtur **20 sesione** që përfshinin aktivitete nga Kurset A-F dhe Computer Science Discoveries.



Trajnimet online u zhvilluan nga data 7 maj 2024 deri më 24 qershor 2024, në katër orare të ndryshme.



Janë trajnuar mbi **1600 mësimdhënë**s nga 24 komuna dhe mbi 350 shkolla të ndryshme në gjithë Kosovën.



 [www.shpik.org](http://www.shpik.org)

 [admin@shpik.org](mailto:admin@shpik.org)

 044 507 575

 Skano QR kodin

